



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2024:066711

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644447

P.nr.161/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit S. B. nga Obiliqi, i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor neni 185 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.184/24F të datës 05.03.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar jopublik të mbajtur me datë 22.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Eset Rama, i dëmtuari M. B. dhe i akuzuari S. B. me datë 24.04.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 29.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. B., i biri i R..... dhe nëna V....., e gjinisë G....., i lindur me, në F.... K....., me vendbanim në fshatin P..... KK, me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Rom, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 22.02.2024, rreth orës 20:00, në fshatin P..... në rrugën ‘‘V.....’’ në O....., konkretisht në shtëpinë e tyre, për shkak të mosmarrëveshjeve me të dëmtuarin-vëllain e tij M. B., i pandehuri, ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarit, me qëllim të shkaktimit të lëndimeve trupore, në atë mënyrë, përderisa i dëmtuari ishte në shtëpi, i pandehuri ka filluar të fjaloset me të, për shkak se i dëmtuari i kishte thënë, pse e largove vëllain nga shtëpia, e shtine në burg, këto fjalë nuk i pëlqeu të pandehurit, atëherë ka filluar ta sulmojë fizikisht të dëmtuarin, duke e goditur me një shkop në dorë dhe në këmbë, e kapur për fyti, më pas në prezencën e policisë, ka kanosur në gjuhën rome ‘‘a mendoni ju se unë kthena prapë në shtëpi’’, si pasojë e këtyre veprimeve, të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndimet e lehta trupore, me pasojë të përkohshme për shëndetin, në formë të gërvishtjes lëkurore në kofshën e këmbës së djathtë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 185 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

DENIM ME KUSHT

- I. Ashtu që te pandehurit i përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbaj nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprën e re penale.
- II. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. I dëmtuari M. B udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në procedurë civile.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.184/24F të datës 05.03.2024, ndaj të akuzuarit S.B. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 22.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Eset Rama, të dëmtuarit M. B. dhe të pandehurit S. B., ku i pandehuri u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit S. B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-74.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa rrethana rënduese nuk janë konstatuar nga Gjykata me përjashtim të faktit se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.161/24 datë 30.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.